



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
KOMISIONI INSTITUCIONAL ZGJEDHOR

Nr. 178 Prot.

Tiranë, më 28/10/2021

Lënda: Përcillet Vendimi nr. 41, datë 28.10.2021 i KIZ

Drejtuar: KZF-ve të Njësive Kryesore të UMT-së

Për dijëni: Dekanit të Fakultetit të Mjekësisë, UMT
Dekanit të Fakultetit të Dentare, UMT
Dekanit të Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike, UMT

Të nderuar,

Bashkëlidhur ju përcjellim për njohje dhe zbatim Vendimin nr. 41, datë 28.10.2021 i KIZ.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KRYETAR

SILVANA BALA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
KOMISIONI INSTITUCIONAL ZGJEDHOR

Nr. 177 Prot.

Tiranë, më 28 / 10 / 2021

V E N D I M

Nr. 44 datë 28 . 10 . 2021

**PËR FILLIMIN E PROCESIT ZGJEDHOR PËR ZGJEDHJET E ANËTARËVE TË
KOMISIONEVE TË PËRHERSHME PËR DHËNIEN E GRADËS SHKENCORE
“DOKTOR” NË NJËSITË KRYESORE TË UNIVERSITETIT TË MJEKËSISË,
TIRANË**

Në zbatim të Nenit 4, 5 6 e në vijim, të Rregullores së Zgjedhjeve miratuar me Vendimin nr. 13, datë 12.02.2020 të Senatit Akademik “Për miratimin e Rregullores për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese dhe komisionet e përherëshme në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”, Vendimin nr. 78, datë 13.10.2021 dhe në Urdhrin nr. 120, datë 26.10.2021, të Rektorit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, “Për fillimin e procesit zgjedhor dhe caktimin e datës së zhvillimit të zgjedhjeve për Komisionin e Përherëshëm për dhënien e gradës shkencore “Doktor” në nivel njësie kryesore, në të 3 (tri) njësitë në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”, KIZ në mbledhjen e datës 28.10.2021:

VENDOSI:

1. Të shpallë fillimin e procesit zgjedhor për zgjedhjen e anëtarëve të Komisioneve të Përherëshme në:
 - 1) Fakultetin e Mjekësisë, UMT
 - 2) Fakulteti i Mjekësisë Dentare, UMT
 - 3) Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike, UMT
2. Të miratojë periudhën e zhvillimit të procesit zgjedhor nga data 27.10.2021 deri në 24.11.2021 dhe datën 24.11.2021, datën e votimit për zgjedhjen e anëtarëve të Komisioneve të Përherëshme sipas pikës 1.
3. Komisionet e Zgjedhjeve të Fakultetit të Mjekësisë, Fakultetit të Mjekësisë Dentare dhe Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike, UMT, të nisin procedurën e pranimit të aplikimeve të kandidatëve për anëtarë të Komisioneve të Përherëshme nga **data 01.11.2021**

deri në datë 05.11.2021 dhe të shpallin listën përfundimtare të aplikantëve sipas përcaktimeve të Rregullores të Zgjedhjeve në UMT.

4. Formularët e aplikimit të dorëzohen pranë KZF së përkatëse, sipas përcaktimeve të pikës 3 të këtij vendimi, si dhe në zbatim të Urdhrit të Rektorit të UMT-së nr. 119, datë 26.10.2021, *“Për përcaktimin e kriterëve që duhet të plotësojnë dhe dokumentacionin që duhet të dorëzojnë kandidatët për anëtar të Komisionit të Përhershëm për dhënien e Gradës shkencore “Doktor” në nivel njësie kryesore në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”*
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, afishohet në mjediset e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, publikohet në faqen zyrtare të internetit të UMT, një kopje e tij i dërgohet KZF-ve të Fakulteteve të Universitetit të Mjekësisë dhe drejtuesve të njësive kryesore të UMT.

KRYETAR

SILVANA BALA

